

VENDIM
Nr. 547, datë 1.10.2025

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.7.2024, PËR ÇËSHTJEN “MELI DHE *SWINKELS FAMILY BREWERS N.V.* KUNDËR SHQIPËRISË” (KËRKESAT NR. 41373/21 DHE 48801/21)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2024, për çështjen “Meli dhe *Swinkels Family Brewers N.V.* kundër Shqipërisë”, përfundimtar në datën 16.10.2024, për kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1, në vlerën që detyrohet shteti shqiptar, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2024, për çështjen “Meli dhe *Swinkels Family Brewers N.V.* kundër Shqipërisë”, përfundimtar në datën 16.10.2024, për kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesit Astrit Meli dhe shoqërisë kërkuese “*Swinkels Family Brewers N.V.*” të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Numri i kërkesës	Titulli i çështjes	Kërkuesit	Dëm jopasuror ¹	Kostot dhe shpenzimet ²
41373/21	Meli kundër Shqipërisë	Astrit Meli	3 600 euro	4 000 euro
48801/21	Swinkels Family Brewers N.V. kundër Shqipërisë	Shoqëria “Swinkels Family Brewers N.V.	3 600 euro	6 000 euro

¹ Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.

² Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.